

*Our Mission:
Supporting improved
educational opportunities for
the children and youth of the
isolated Malesia e Madhe
region of Northern Albania*

President: Steve Cook, PhD

Secretary: Terri Cook

Board of Directors:

Karen Berg

Mary Alice Seville

Nancy Leeper

Kristina Milaj

Mona Jones-Romansic

Albania Manager:

Marash Rakaj

Albanian Alps Institute
8600 NW Oak Creek Drive
Corvallis, OR 97330

Phone: 541-230-1285

Email: albanianalpsinst@gmail.com

Website: www.albanianalps.org

BURSISTE E AAI



Viti 2017 ka qenë një vit i rëndësishëm për ish-nxënësen e AAI, Toneta (Durgaj) Olaj. Toneta ka lindur në fshatin Ducaj dhe ka dy motra dhe një vëlla. Me ndihmën e AAI, ajo u diploma në shkollën e mesme në vitin 2011 dhe pastaj vazhdoi studimet në Universitetin e Shkodrës, ku jo vetëm që mori diplomën “bachelor” në matematikë, por edhe diplomën e masterit në matematikë dhe fizikë. Në 2017, ajo u martua me një tjetër ish-bursist të AAI, Angjelin Olaj, dhe më pas filloi punë si mësuese në shkollën 9-vjecare “Fran Murriz” në Pjetroshtan. Aktualisht, Angjelini është mësues i Anglishtes në tre shkolla: Bogë, Xhaj, dhe Dedaj. Toneta dhe Angjelini jetojnë në Shkoder. Urime Toneta në realizimin e ëndërrës tuaj për tu bërë mësuese e matematikës. Ne jemi krenar për ty!

2017 VULLNETAR

“Ky udhëtim ka qenë një përvojë e pabesueshme.” “Të gjitha familjet pritëse ishin shumë të dashura dhe mikëpritëse...” “Pata mundësi të perjejoj plotësisht kulturën”, “Ishte kënaqësi të takoj njerëzit dhe të fitoj miqësi të reja.” Këto janë disa nga përgjigjet e vullnetarve që shkuan në Shqipëri me z. Steve këtë verë. Tetë studentë në shkollën e mesme dhe një student në universitet kaluan gati tre javë nëpër fshatra. Ata u organizuan në dy grupe dhe mësuan të bashkëbisedonin në Anglisht në Vrith, Bogë, dhe në Xhaj. Në Vrith, banori vendas, Bernard Milaj, ishte një mbështetje e madhe. Përveç se praktikuan Anglisht dhe vizatim, ata kaluan një fundjavë të gjatë në Ulqin, Mal i Zi, në brigjet e Adriatikut për notë dhe plazhë. Steve shkoj si mbikqyrës, por këta studenta ishin shumë të përgjegjshëm, dhe vërtet nuk kishin nevojë për mbikqyrje. Steve i mori të gjithë në një udhëtim



këmbësor të gjatë në Bogë, po ashtu ata u ngjiten në majen e Malit të Veleçikut afër Razmës. Në të dyja vendndodhjet, fëmijët vendas i mbanin të zënë aq gjatë, sa që ata ishin shpesh të lodhur nga volejboli, futbollit, dhe ecja me këmbë. Udhtimi kulmoj me një mbledhje të nxënësve shqiptarë në Dedaj, shoqëruar me tortë, akulllore, dhe një lojë “Jeopardy”. Faleminderit të gjithë vullnetarve për dedikimin dhe punën tuaj të palodhshme. Ishtë një experiencë pozitive për studentët Shqiptarë të dëgjojnë Anglishten e folun dhe të bashkëbisedojnë me nxënës bashkëmoshatarë. Ju lutem shihni faqen e internetit tonë për informacion se si mund të bëheni vullnetarë të AAI.



Letër nga Presidentii AAI, Steve Cook

Në vitet e fundit, udhtimet e mia kanë pasur të njëjtën strukturë, por jo në 2017, kur unë kisha vullnetarë të nxënës të vitit të III-të nga Shkolla e Mesme Corvallis dhe një student nga Universiteti Shtetëror i Oregonit. Nuk dhashë mësim vetë këtë vit, sepse isha i zënë duke ndihmuar me organizimin e klasave. Në vendosëm të ndryshojmë programin e bursave me qëllim që të përqendrohemi më tepër në meritën e nxënësit, bazuar në provimin e shtetit, dhe do vazhdojmë me programet tona të suksesshme, si pak mjete/pajisje mësimdhënëse, mbështetje të librarive, mësimdhënje për kopshtet dhe gjuhën Angleze. Ne, gjithashtu do vazhdojmë të mbështesim studentët e përparuar në universitete. Ne jemi të lumtur të punsojmë Vitore Leshaj si mësuese artit në Bogë dhe Xhaj. Ajo do të menaxhojë dhe librarinë në shkollën e Bogës. Duke qenë se shteti ofron Anglisht në shkollat Bogë dhe Xhaj, ne kemi dërguar mësuesin tonë të Anglishtes, Aleks Vulaj të japi mësim një ditë në javë në të dy shkollat duke mbështetur sistemin e shtetit. Vitin tjetër ne do organizojmë edhe një tjetër “Ditë karriere” e cila ka dëshmuar të ketë shumë interes nga nxënësit. Përsëri, një falenderimi të përzemërt për të gjithë ju që vazhdoni të mbështesni organizatën tonë. Nxënësit e këtyre fshatrave të vegjël përfitojnë shumë nga bujaria juaj.



Amazon Smile është një mënyrë e thjeshtë dhe automatike për të mbështetur organizatën tuaj të preferuar bamirëse, pa ju kushtuar juve asnjë lek. Kur blini në smile.amazon.com, ju do gjeni ekzaksisht të njëjtat produkte dhe çmime si në Amazon.com, por me bonus, sepse Amazon do të dhuroj 0.5% të çmimit të artikujve që ju blini për organizatën tuaj të preferuar.

Herën e parë që shkoni në smile.amazon.com, hyni një lloj si tek Amazon.com. Atëherë përzgjidhni organizatën bamirëse që ju dëshironi të mbështesni (shpresoj që të jemi ne). Amazon e mban mend zgjedhjen tuaj dhe c'do blerje e juaja nëpërmjet smile.amazon.com rezulton në një donacion nga Amazon për organizata që ju zgjodhët. Vetëm mbaj mend të shkoni në smile.amazon.com, hyr si zakonisht dhe vazhdoni blerjen!